

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktima ndëshkohen njësoj
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/aksidenti-autori-i-dehur-i-perplasjes-dhe-viktima-ndeshko-hen-njesoj/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:27:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:19:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c104e6ea545a6de9c438dc21b0d713c0a91312f8e65b8e849c3e72fa6348d429
TEKSTI	24e3382c95e5f09298efb13e25db71f321521b7de3ea14abcb090f06eecd67f6
PAMJA	5186cd97b1c2410dc0cd29fe5145b981e13f3793b2d6c1e5425c186c58c32f1e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d917e27625c2c1118db5002f44b9f02c1a294a62ebb68ccd3b227cb1bf61b140
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d917e27625c2c1118db5002f44b9f02c1a294a62ebb68ccd3b227cb1bf61b140>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktimja ndëshkohen njësoj

21:19 : 15/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Rasti i trajtuar në emisionin "Stop", këtë të martë, më 15 shtator, lidhet me qytetarin Viktor Thaqi, i cili tregon, se më 22 gusht 2026 po udhëtonte drejt Shkodrës, kur automjeti, ku ndodhej me bashkëshorten në drejtim, u përplas me një furgon.

Pas aksidentit, të dy drejtuesit u ndëshkuan me gjobë për manovra të gabuara dhe goditje, ndërsa drejtuesi tjetër rezultoi edhe nën efektin e alkoolit dhe u gjobit me 180 mijë lekë të vjetra.

Thaqi kundërshtoi masën e vendosur ndaj tyre, pasi sipas tij, kompania e sigurimit mbulon vetëm 50% të dëmit, për shkak të gjobës dhe pretendon, se vendimi i policisë është i padrejtë.

Punonjësi i policisë, që shkoi në vendngjarje, pranon, se nuk e ka parë aksidentin dhe se masën e ka vendosur, bazuar në deklaratat kontradiktore të dy drejtuesve.

Kamerat e subjektit pranë vendit të aksidentit nuk janë marrë, pasi sipas policit i është thënë, se nuk funksiononin. Madje, polici i sugjeron qytetarin, se sigurimi i pamjeve filmike mund të shërbejë për anulimin e gjobës.

Eksperti autoteknik Gëzim Hoxha ngre pikëpyetje mbi mënyrën e përcaktimit të përgjegjësisë. Sipas tij, në një përplasje ka një mjet, që godet dhe një tjetër, që goditet, ndaj nuk mund të trajtohen automatikisht të dy drejtuesit si autorë të së njëjtës shkelje.

Lexo edhe:

[FOTO/ Aksidenti në aksin Lezhë-Shkodër, tre të plagosur](#)[Aksidenti i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës](#)**Qytetari** – Si je?**Policia** – Çka bane?**Qytetari** – Ti e ke bërë atje, që godasin njëri-tjetrin.**Policia** – Të dy thonë, njëri thotë më ka godit ai, tjetri thotë më ka godit ai. A e kupton shokun tënd? Janë të dy deklaratat ashtu. Kur kam qenë unë tu ik për punë, unë i kam pa të dy të parkum.

TË GJITHA

**Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktimja ndëshkohen njësoj**

21:19 : 15/09/2026

**OKB ngre alarmin për inteligjencën artificiale: Rreze të paprecedentë**

21:10 : 15/09/2026

**"Punë oligarkësh", apo jo z.zëvendësministër?**

21:00 : 15/09/2026

**Video/ Pas Ballukut, edhe Balla përball me protestuesit: O hajdut, o hajdut**

20:53 : 15/09/2026

**Ja sa miliona jetë mund të shpëtojë një taksë 3% mbi pasurinë e miliarderëve**

20:40 : 15/09/2026

**Rama përballë drejtësisë që reformoi**

20:33 : 15/09/2026

**Tre të vranë nga të shtënat me armë në një dyqan në Stamboll**

20:27 : 15/09/2026

Qytetari – Po atë e gjete me alkool 1.25?

Polici –Jo 1.25, jo 1.25 shkon në kokërr të burgut ai, po është 0.21.

Qytetari – Po kamerat e kësaj, i merr dot?

Polici –Jo s'i marr dot. Kam shku me i marrë dhe nuk i marr dot.

Qytetari – Nuk i kanë, apo s'i japin?

Polici –O vlla, nuk e di! Unë thjesht kam ardh, kam pyet edhe për vete, që mos të më ndodhin këto.

Qytetari – Po!

Polici –Kto gjonash, jo po ishte, jo po s'ishte. S'punon kamera,- tha, kaq. Kaq më ka thënë. Nuk ia marr dot me zor kurrkujt, asnjënit. Kamerat i merr vetëm me vendim prokurorie, vlla.

Qytetari – Unë atje, që kërkoj të anulloj gjobën, e anulloj, sepse nuk është vënë e saktë.

Polici – Shumë mirë! Në qoftë se ti arrin me marrë kamerat, mund ta anullos, o vlla, se unë gjobën e bëj në bazë të deklaratës. /Emisioni STOP

Etiketa: Aksident | denoncimi | Shkoder

Lajme të lidhura



FOTO/ Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, tre të plagosur

17:44 : 15/09/2026



Aksident i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës

16:47 : 15/09/2026



Aksident në aksin Fier-Mallakastër, tre të plagosur

13:37 : 14/09/2026




Aksident i rëndë në aksin Bradashesh-Peqin, humb jetën 70-vjeçari

12:01 : 14/09/2026



Aksident në aksin Qishbardhë-Peshkëpi, përplasen dy makina, disa të plagosur

14:59 : 13/09/2026



DETAJE nga tritoli në Shkodër/ Autori u maskua si korrier picash, objektiv vëllai i mësuesit ?

13:36 : 13/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

